



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

V E N D I M

Nr. 13 Datë 05. 09. 2017

“ PËR MIRATIM E LEJES PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR PËR ENERGJI
ELEKTRIKE” SUBJEKTIT “LASTER ENERGY” SH.P.K.

Në mbështetje të nenit 7 pika 2 ,të nenit 50, nenit 51, nenit 52, të ligjit nr 111/2012 dt.15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 si dhe të nenit 24, pika f, të VKM Nr. 822 datë 07.10.2015, “ Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike , që nuk janë objekt konçesioni”, miratimin paraprak Nr.2836/3, datë 12.11.2016 të MEI, për paisjen me leje të përdorimit të burimit uJOR të subjektit “**LASTER ENERGY**” SH.P.K., me propozim të A.B.U Drin- Bunë, miratimin në parim të Këshillit Konsultativ dhe oponentës së DPBU në ministrinë përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore, Këshilli i Basenit UJOR Drin- Bunë,

V e n d o s i:

1-Miratimin e lejes së subjektit “**LASTER ENERGY**” sh.p.k. me administratore Znj.Jultila LAMANI, për përdorim të burimit uJOR **Përroi i Shehut**, degë e Lumit të Setës, degë e Lumit Drini i Zi,për prodhim energjie elektrike në Çidhën,Njësia Administrative Arras, Bashkia Peshkopi, Qarku Dibër.

Sipas studimit të paraqitur nga subjekti HEC KRONZ do të ketë këto të dhëna:

Koordinatat e veprës së marrjes: X – 44 40 711.38 ; Y – 46 24 060.4; Z – + 712.3 m;

Koordinatat e godinës së centrali: X – 44 40 621.17; Y – 46 23 361.06; Z - + 584 m;

Koordinatat e pikës së shkarkimit : X – 44 40 621.17; Y – 46 23 361.06; Z - + 584 m ;

Prurja mesatare e burimit uJOR: Qmes=0.31m³/sek;

Sasia e ujit që kërkohet të përdoret nga subjekti: Q llog = 0.4 m³/sek;

Prurja ekologjike: Q ekol= 0.328 m³/sek;

Prurja që shkarkohet: Q= 0.4 m³/sek

2-Leja e përdorimit të burimit uJOR për prodhim energjie elektrike jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zone dhe rezerva e domosdoshme ekologjike.

3- Ngarkohet A.B.U. Drin-Bunë për zbatimin e këtij vendimi.

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË

Sekretari

Martin PLLUMBI

Kryetar

Paulin RADOVANI

